

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

LICENCIME

ÇMIMI I ENERGJISË

NJOFTIME



**MBLEDHJE
BORDI**

MIRATIMI I RREGULLAVE TË HARMONIZUARA TË ALOKIMIT TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT PËR ZYRËN E KOORDINIMIT TË ANKANDEVE NË ERUROPËN JUGLINDORE (SEE CAO) PËR KUFIJTË SHQIPËRI - GREQI, SHQIPËRI - MAL I ZI DHE SHQIPËRI - KOSOVË.

Këto rregulla janë miratuar në datën 3 Qershor 2022, nga Bordi Drejtues i SEE CAO, dhe i janë nënshtruar konsultimit të organizuar nga SEE CAO, gjatë të cilit çdo palë interesi ka patur mundësinë të japë komentet apo sugjerimet përkatëse. Gjatë këtyre konsultimeve të realizuara nga Zyra e Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit me seli në Podgoricë, rezultoi se nuk pati asnjë propozim apo kërkesë për ndryshim të akteve të publikuara nga asnjë prej paleve të interesit. Aplikimi i këtyre rregullave fillon në vitin 2022 dhe do të shërbejë për alokimin e kapaciteteve që do të zhvillohem për vitin pasardhës, 2023. Këto rregulla bazohen në parimet e vendosura në Traktatin e Komunitetit të Energjisë të nënshkruar dhe nga Shqipëria, në lidhje me harmonizimin e metodave për menaxhimin e konxhestioneve në Interkonjeksion.

Për tu azhurnuar me subjektet e licencuara gjatë muajit tetor ju lutem vizitoni linkun [Regjistri i licencimeve](#).

ERE miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Shtator 2022, prej:

- **31.15 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV; (Vendim Nr.261, Datë 14.10.2022)**

**FMF
PËR MUAJIN TETOR**

ÇMIMI I ENERGJISË MBETET I PANDRYSHUAR PËR MUAJIN TETOR.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

AKTIVITETE

Në kuadër të Tetorit Rozë, muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, ERE në mbyllje të një muaji mjaft impenjativ, mirëpriti doktoreshën Oltiana Petri, e cila ndau me vajzat dhe gratë e Institucionit informacion të vlefshëm mbi llojet e kancerit të gjirit, kontrollet e nevojshme, vështirësitë e kurimit dhe impaktin psikologjik të të jetuarit me këtë sëmundje. Në një bashkëbisedim me stafin pjesëmarrës, doktoresha ndau eksperiencën e saj si mjeke dhe si e mbijetuar nga kjo sëmundje duke ngulmuar fort tek rëndësia e zbulimit të hershëm.

#TETORIROZË

Kryetari i ERE-s z.Petrit Ahmeti pati kënaqësinë të merrte pjesë në aktivitetin e organizuar nga Ambasada Amerikane në Tiranë, në të cilën USAID-i mbledhi partnerë nga i gjithë vendi për të festuar 30 vjetorin e USAID-it në Shqipëri dhe zhvillimin të përbashkët. USAID ka qënë dhe mbetet një partner me rëndësi për Entit Rregullator të Energjisë ndër vite, që nga krijimi i rregullatorit, apo tek bashkepunimet dypalëshe me Rregullatorin e Ohaios, tek metodologjitë e tarifave, rregullave të tregut, apo dhe rregullores së Cybersecurity që u mundësua nga ky bashkëpunim i frytshëm.



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

TRAJNIME

SENSIBILIZIM



ENERGY REGULATORS
REGIONAL ASSOCIATION



Enti Rregullator i Energjisë

Në datë 10 tetor, u organizua takimi i grupit të punës së konsumatorit, të ERRA (Rregullatorët e vendeve të rajonit). E ftuar për të prezantuar aktivitetin e ERE sa i përket informimit dhe edukimit të konsumatorit, ishte komisionerja e ERE znj.Erjola Sadushi.

Ajo prezantoi për këtë grup, në pjesëmarrje të të cilit ishin përfaqësues të të gjithë rregullatorëve të vendeve të rajonit, punën e kryer nga ERE me qëllim përmbushjen e këtij misioni të rëndësishëm të edukimit dhe informimit të konsumatorit sa i përket aktivitetit të ERE si dhe njohjes së konsumatorit me të drejtat e tyre dhe mundësitë që ligji i ofron për të përfutur jo vetëm shërbim të mirë, por edhe cilësor e me kosto më të ulëta.